6.4.3 Sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët, laboratorët, me iniciativën dhe shpenzimet e tyre, mund të analizojnë Mostrat për Substancat e Ndaluara ose Metodat e Ndaluara që nuk përfshihen në menynë e analizave të Mostrave të përkrahur në Dokumentin Teknik ose të specifikuar nga autoriteti i Analizave. Rezultatet nga një analizë e tillë raportohen dhe kanë të njëjtën vlefshmëri dhe pasoja si çdo rezultat tjetër i analizave.

[Koment për Nenin 6.4: Objektivi i këtij Neni është zgjerimi i parimit të "Analizave inteligjente" në menynë e analizave të Mostrave për të zbuluar dopingut më me efektivitet dhe efikasitet. Njihet që burimet e disponueshme për të luftuar dopingun janë të kufizuara dhe që zgjerimi i menysë së analizave të Mostrave, në disa sporte dhe vende, mund të ulë numrin e Modeleve që mund të analizohen.]

6.5 Analizë e mëtutjeshme e mostrave

Çdo Moster mund të ruhet dhe më vonë të përdoret për analiza të mëtejshme për qëllimet e parashikuara në Nenin 6.2: (a) nga WADA në çdo kohë; dhe (b) nga FKK-ja në çdo kohë para se t'i jenë komunikuar rezultatet e analizave të Mostrave A dhe B (ose rezultatit të Mostrave, nëse nga analiza e Mostres B është hequr dorë ose nuk do të kryhet) nga FKK-ja Atletit si bazë pohuese për shkeljen e rregullit Antidopingtë Nenit 2.1. Një analizë e tillë e mëtutjeshme e Mostrave përputhet me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Laboratorët dhe Standardin Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet.

NENI 7 MENAXHIMI I REZULTATEVE

7.1 Përgjegjësia për Zhvillimin e Menaxhimit të Rezultateve

7.1.1 FKK merr përgjegjësinë për menaxhimin e rezultateve në lidhje me Atletët dhe Personat e tjerë nën juridiksionin e tij Antidopingnë pajtim me parimet e parashikuara në Nenin 7 të Kodit.

7.1.2 Me synim përcaktimin e përgjegjësisë për menaxhimin e rezultateve, nëse FKK zgjedh të mbledhë Mostrat shtesë në rrethanat e parashikuara në Nenin 5.2.4, ai konsiderohet Organizata Antidoping që ka filluar dhe drejtuar mbledhjen e Mostrave.

7.1.3 Kreu i FKK-së emëron një Panel për Rishikimin e Dopingut që përbëhet nga një Kryetar dhe 2 anëtarë të tjerë me eksperiencë në antidoping. Çdo anëtar paneli ka një mandat prej katër vjetësh. Nëse një shkelje e mundshme i referohet Panelit të Rishikimit të Dopingut nga FKK-ja, Kryetari i Panelit të Apelit emëron një ose më shumë anëtarë të Panelit (që mund të përfshijnë Kryetarin) të kryejnë rishikimin e diskutuar në këtë Nen.

7.2 Rishikimi i Konstatimeve Analitike Anormale nga Testet e filluara nga FKK-ja

Menaxhimi i rezultateve në lidhje me rezultatet e analizave të filluara nga FKK zhvillohen si më poshtë:

7.2.1 Rezultatet nga të gjitha analizat duhet t'i dërgohen FKK-së në formë të koduar, në një raport të nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i laboratorit. I gjithë komunikimi duhet të kryhet në konfidencialitet dhe në pajtim me ADAMS.

7.2.2 Me marrjen e një Konstatimi Analitik Anormale, FKK kryhen një rishikim për të përcaktuar nëse: (a) është dhënë një TUE (Therapeutic Use Exemption) e zbatueshme ose do të jepet sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Përrjashtimet e Përdorimit Terapik, ose (b) ka një shmangie të dukshme nga Standardi Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që ka shkaktuar Konstatimin analitik Anormale.

7.2.3 Nëse rishikimi i një Konstatimi Analitik Anormale sipas Nenit 7.2.2 tregon që një TUE e zbatueshme ose një shmangie nga Standardi Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që ka shkaktuar konstatimin Analitik Negativ, e gjithë analiza konsiderohet negative dhe Atleti, Federata Ndërkombëtare e Atletit dhe Federata Kombëtare e Atletit dhe WADA vihen në dijeni.

7.3 Njoftimi pas Rishikimit në lidhje me Konstatimet Analitike Anormale

7.3.1 Nëse rishikimi i një Konstatimi analitik Anormale sipas Nenit 7.2.2 nuk tregon një TUE të zbatueshme ose një të drejtë për një TUE sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Përrjashtime të përdorimit Terapik, ose shmangie nga Standardi Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që ka shkaktuar Konstatimin Analitik Anormale, FKK-ja njofton menjëherë Atletin dhe njëkohësisht Klubin e Atletit, dhe WADA-n në mënyrën e parashikuar në Nenin 14.1, për: (a) Konstatimin analitik Negativ; (b) rregullin Antidoping të shkelur; (c) të drejtën e Atletit për të kërkuar analizën e Mostrës B ose, nëse një kërkesë e tillë nuk bëhet brenda afatit të përcaktuar, që nga analiza e Mostrës B konsiderohet sikur është hequr dorë; (d) datën, orën dhe vendin e planifikuar për analizën e Mostrës B nëse Atleti ose FKK-ja zgjedh të kërkojë një analizë të Mostrës B; (e) mundësinë për Atletin dhe/ose përfaqësuesin e Atletit për të ndjekur hapjen e Mostrës B dhe analizën në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët; dhe (f) të drejtën e Atletit për të kërkuar kopje të paketës së dokumentacionit të laboratorit për Mostrën A dhe B që përfshin informacionin që kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët. Nëse FKK-ja vendos për të mos e nxjerrë Konstatimin Analitik Anormale si shkelje e rregullit antidoping, ai për këtë njofton Atletin, Klubi i Atletit, dhe WADA-n.

7.3.2 Nëse kërkohet nga Atleti ose FKK-ja, merren masa për të analizuar Mostrën B në pajtim me Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët. Një Atlet mund të pranojë rezultatet analitike të Mostrës A duke hequr dorë nga kërkesa për analiza të Mostrës B KFF megjithatë mund të zgjedhë të procedojë me analizën e Mostrës B.

7.3.3 Atleti dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk lejohet të jetë i pranishëm në analizën e Mostrës B. Pra, një përfaqësues i Federatës Kombëtare të Atletit lejohet të jetë i pranishëm.

7.3.4 Nëse analiza e Mostrës B nuk konfirmon analizën e Mostrës A, (përveç kur FKK-ja e shpall çështjen si një shkelje të rregullit Antidopingsipas Nenit 2.2) e tërë analiza konsiderohet negative dhe Atleti, Klubi e Atletit, dhe WADA vihen në dijeni.

7.3.5 Nëse Analiza e Mostrës B konfirmon analizën e Mostrës A, konstatimet i raportohen Atletit, Klubit të Atletit, Federatës Kombëtare të Atletit dhe WADA-s.

7.4 Rishikimi i Gjetjeve Atipike

7.4.1 Sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët, në rrethana të caktuara laboratorët udhëzohen të raportojnë praninë e Substancave të Ndaluara që mund të prodhohen gjithashtu në mënyrë endogjene, si Konstatime Atipike, d.m.th., si konstatime që u nënshtrohen hetimeve të mëtejshme.

7.4.2 Me marrjen e një Konstatimi Atipik, FKK zhvillon një rishikim për të përcaktuar nëse: (a) është dhënë një TUE e zbatueshme ose do të jepet sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Përfundimet për Përdorim Terapik, ose (b) ka një shmangie të dukshme nga Standardi Ndërkombëtar për analiza dhe Hetime ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që kanë shkaktuar Konstatimin Atipik.

7.4.3 Nëse rishikimi i një Konstatimi Atipik sipas Nenit 7.4.2 tregon një TUE të zbatueshme ose një shmangie nga Standardi Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që ka shkaktuar Konstatimin Atipik, të gjitha analizat konsiderohen negative dhe Atleti, Federata Ndërkombëtare e Atletit, Klubi i Atletit dhe WADA vihen në dijeni.

7.4.4 Nëse ky rishikim nuk tregon një TUE të zbatueshme ose një shmangie nga Standardi ndërkombëtar për Analizat dhe hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që ka shkaktuar Konstatimin Atipik, FKK-ja kryhen hetimin e kërkuar ose kërkon që ai të kryhet. Pas kryerjes së hetimit, afirmohet Konstatimi Atipik si një Konstatim Analitik Anormal në pajtim me Nenin 7.3.1, ose Atleti, Federata Ndërkombëtare e Atletit, Federata Kombëtare e Atletit dhe WADA njoftohen që Konstatimi Atipik nuk do të afirmohet si një Konstatim Analitik Anormal.

7.4.5.1 Nëse FKK-ja përcakton që Ekzemplari B duhet të analizohet para përfundimit të hetimit të tij, ai mund të kryejë analizën e Ekzemplarit B pasi njofton Atletin, ku ky njoftim përfshin një përshkrim të Konstatimit Atipik dhe informacionin e përshkruar në Nenin 7.3.1(d) – (f).

7.5 Rishikimi i Konstatimeve Atipike të Pasaportës dhe Konstatime Negative të Pasaportës

Rishikimi i Konstatimeve Atipike të Pasaportës dhe Konstatimeve Anormale të Pasaportës kryhet sipas parashikimit në Standardin Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet dhe Standardin ndërkombëtar për Laboratorët. Në momentin që FKK-ja është i bindur që ka ndodhur një shkelje e rregullit anti-doping, ai i bën menjëherë njoftim Atletit (dhe njëkohësisht

Klubin e Atletit, dhe WADA-s) për shkeljen e rregullit Antidoping të pretenduar dhe bazën e pretendimit.

7.6 Rishikimi i Mosdhënies së Informacionit mbi Vendndodhjen

FKK-ja rishikon mosdepozitimet dhe moskryerjen e mundshme të analizave (sipas përcaktimit në Standardin Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet) në lidhje me Atletët që depozitojnë informacionin mbi vendndodhjen e tyre tek FKK-ja, në pajtim me Aneksin I të Standardit Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet. Në momentin që FKK-ja është i bindur që ka ndodhur një shkelje e rregullit Antidoping të Nenit 2.4, ai i bën menjëherë njoftim Atletit (dhe Klubin e Atletit, dhe WADA-s) që pretendon shkeljen e Nenit 2.4 dhe bazën e pretendimit.

7.7 Rishikimi i Shkeljeve të tjera të Rregullit Antidoping që nuk mbulohen nga Nenet 7.2–7.6

FKK-ja kryhen çdo hetim pasues që kërkohet në një shkelje të mundshme të rregullit Antidoping që nuk mbulohet nga Nenet 7.2 – 7.6. Në momentin që FKK-ja është i bindur që ka ndodhur një shkelje e rregullit anti-doping, ai i bën menjëherë njoftim Atletit ose Personit (dhe njëkohësisht Klubit të Atletit, dhe WADA-s) për shkeljen e rregullit Antidoping të pretenduar dhe bazën e pretendimit.

7.8 Identifikimi i Shkeljeve të Mëparshme të Rregullit Antidoping

Para se t'i bëhet njoftim Atletit ose Personit tjetër për një shkelje të pretenduar të rregullit Antidoping sipas parashikimit të mësipërm, FKK-ja i referohet ADAMS-it 31 dhe kontakton WADA-n dhe Organizatat e tjera përkatëse Antidoping për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë shkelje e mëparshme rregullit anti-doping.

7.9 Pezullimet e Përkohshme

7.9.1 Pezullimi i Përkohshëm i Detyrueshëm:

Nëse analiza e një Mostre A ka rezultuar në një Konstatim Analitik Anormal për një Substancë të Ndaluar që nuk është një Substancë e Specifikuar ose për një Metodë të Ndaluar, dhe një rishikim në pajtim me Nenin 7.2.2 nuk tregon një TUE të zbatueshme ose shmangie nga Standardi Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet ose Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët që kanë shkaktuar Konstatimin Analitik Anormal, vendoset një Pezullim i përkohshëm në momentin e njoftimit ose menjëherë pas njoftimit të përshkruar në Nenet 7.2, 7.3 ose 7.5.

7.9.2 Pezullimi i përkohshëm opsional:

Në rastin e një Konstatimi Analitik Negativ për një Substancë të Specifikuar ose në rastin e një shkeljeje tjetër të rregullit Antidoping që nuk mbulohet nga Neni 7.9.1, FKK-ja mund të

vendosë një Pezullim të përkohshëm mbi Atletin ose Personit tjetër ndaj të cilit pretendohet shkelja e rregullit Antidoping në çdo kohë pas rishikimit dhe njoftimit të përshkruar në Nenet 7.2 – 7.7 dhe para seancës përfundimtare të përshkruar në Nenin 8.

7.9.3 Nëse vendoset një Pezullim I përkohshëm në pajtim me Nenin 7.9.1 ose Nenin 7.9.2, Atletit ose Personit tjetër i jepet: (a) një mundësi për një Seancë provizore para ose me një bazë kohore pas vendosjes së Pezullimit të përkohshëm; ose (b) një mundësi për një seancë të përshpejtuar në pajtim me Nenin 8 me një bazë kohore pas vendosjes së Pezullimit të përkohshëm. Për më tepër, Atleti ose Personi tjetër ka të drejtën e ankimit ndaj Pezullimit përkohorë në pajtim me Nenin 13.2 (përveç kur parashikohet në Nenin 7.9.3.1).

7.9.3.1 Pezullimi i përkohshëm mund të hiqet nëse Atleti demonstron para panelit të seancës që shkelja mund të përfshijë një Produkt të kontaminuar. Vendimi i panelit të seancës për të mos hequr Pezullimin e përkohshëm për llogari të pretendimit të Atletit në lidhje me Produktin e Kontaminuar është e pa-ankimueshme.

7.9.4 Nëse Pezullimi I përkohshëm vendoset mbi bazën e një Konstatimi Analitik Anormal të MostraA dhe analiza pasuese e Mostrës B nuk konfirmon analizën e Mostres A, Atleti nuk i nënshtrohet ndonjë Pezullimi tjetër përkohshëm për llogari të shkeljes së Nenit 2.1 Në rrethanat kur Atleti (ose ekipi i Atletit) është hequr nga Gara bazuar në një shkelje të Nenit 2.1 dhe analiza pasuese e Mostrës B nuk konfirmon konstatimin e Mostres A, nëse është e mundur për Atletin ose ekipin të rifutet pa ndikuar ndryshe Garën, Atleti ose ekipi mund të vazhdojnë të marrin pjesë në Garë. Përveç kësaj, Atleti ose ekipi pas kësaj mund të marrë pjesë në Garat e tjera të të njëjtit Aktivitet.

7.9.5 Në të gjitha rastet kur një Atlet ose Person tjetër është njoftuar për një shkelje të rregullit Antidoping por nuk është vendosur mbi të një Pezullim i përkohshëm, Atletit ose Personit tjetër i ofrohet mundësia të pranojë një Pezullim të përkohshëm vullnetarisht në pritje të zgjidhjes së çështjes.

[Koment për Nenin 7.9: Atletët dhe Personat e tjerë kompensohen për një Pezullim të përkohshëm ndaj çdo periudhe në Papërshtatshmëri që vendoset përfundimisht. Shih Nenet 10.11.3.1 dhe 10.11.3.2.]

7.10 Zgjidhja pa Seancë

7.10.1 Një Atlet ose Person tjetër ndaj të cilit pretendohet një shkelje e rregullit Antidoping mund të pranojë atë shkelje në çdo kohë, heqë dorë nga seanca dhe të pranojë Pasojat që autorizohen nga këto Rregulla Antidoping ose (nëse ekziston diskrecion për Pasojat sipas këtyre Rregullave Anti-Doping) që janë ofruar nga FKK-ja.

7.10.2 Si alternativë, nëse Atleti ose Personi tjetër ndaj të cilit është pretenduar një shkelje e rregullit Antidoping nuk e kundërshton këtë pretendim brenda afatit të caktuar në njoftimin e dërguar nga FKK-ja i cili pretendon shkeljen, ai/ajo konsiderohet të ketë pranuar shkeljen, të ketë hequr dorë nga seanca dhe të ketë pranuar Pasojat që autorizohen nga këto Rregulla

Antidopingose (nëse ekziston diskrecion për Pasojat sipas këtyre Rregullave Anti-Doping) që janë ofruar nga FKK-ja.

7.10.3 Në rastet kur zbatohet Neni 7.10.1 ose neni 7.10.2, nuk kërkohet një seancë para panelit të seancave. Në vend të kësaj FKK-ja nxjerr menjëherë një vendim me shkrim që konfirmon kryerjen e shkeljes së rregullit Antidoping dhe Pasojave të vendosura si rezultat i kësaj, duke shprehur të gjitha arsyet për çdo periudhë Papërshtatshmërie të vendosur, duke përfshirë (sipas rasti) një justifikim për shkakun se pse nuk është vendosur periudha e mundshme maksimale e Papërshtatshmërisë. FKK-ja dërgon kopje të atij vendimi tek Organizatat e tjera Antidoping me të drejtën e ankimit sipas Nenit 13.2.3, dhe e Deklaron Publikisht vendimin në pajtim me Nenin 14.3.2.

7.11 Njoftimi i Vendimeve për Menaxhimin e Rezultateve

Në të gjithë rastet kur FKK-ja pretendon kryerjen e një shkeljeje të një rregulli anti-doping, tërheq pretendimin e një shkeljeje të rregullit anti-doping, vendos një Pezullim të përkohshëm ose ka rënë dakord me Atletin ose Personin tjetër për vendosjen e një sanksioni pa seancë, FKK-ja për këtë u bën njoftim sipas parashikimit të Nenit 14.2.1 Organizatave Antidoping me të drejtën e ankimit sipas Nenit 13.2.3.

7.12 Largimi nga Sporti

Nëse një Atlet ose Person tjetër largohet, ndërsa është duke u zhvilluar një proces menaxhimi i rezultateve, FKK-ja që kryen procesin e menaxhimit të rezultateve ruan juridiksionin për të përfunduar procesin e saj të menaxhimit të rezultateve. Nëse një Atlet ose Person tjetër largohet para se të fillojë një proces për menaxhimin e rezultateve, FKK-ja që do të kishte juridiksionin për menaxhimin e rezultateve mbi Atletin ose Personin tjetër në momentin kur Atleti ose Personi tjetër kreu shkeljen e rregullit anti-doping, ka juridiksionin për të kryer menaxhimin e rezultateve.

[Komente për Nenin 7.7: Sjellja nga një Atlet ose Person tjetër para se Atleti ose Personi tjetër t'i nënshtrohej juridiksionit të një Organizate Antidopingnuk do të përbënte një shkelje të rregullit anti-doping, por mund të ishte një bazë legjitime për t'i mohuar Atletit ose Personit tjetër anëtarësinë në një organizatë sportive.]

NENI 8 E DREJTA PËR NJË GJYKIM TË DREJTË

8.1 Procesi Dëgjimor i FKK-së

8.1.1 Nëse FKK-ja i dërgon njoftim Atletit ose Personit tjetër që pohon shkeljen e rregullit Antidoping dhe Atleti ose Personi tjetër nuk hep dorë nga seanca në pajtim me Nenin 7.10.1 ose Nenin 7.10.2, çështja i referohet panelit disiplinor të FKK-së, Komisionit Mjeko-Ligjor për shqyrtim dhe gjykim.

8.1.2 Seancat në pajtim me këtë Nen zhvillohen brenda një afati të arsyeshëm.

8.1.3 Seancat e mbajtura në lidhje me Aktivitetet mund të zhvillohen me bazë të përshpejtuar nëse lejohen nga paneli kryesues.

[Koment për Nenin 8.1.3: Për shembull, një seancë mund të përshpejtohet në vigjilje të një Aktiviteti madhor nëse zgjidhja e shkeljes së rregullit Antidoping është e nevojshme për të përcaktuar aftësinë e Atletit për të marrë pjesë në Aktivitet ose gjatë një Aktiviteti, nëse zgjidhja e çështjes do të ndikojë në vlefshmërinë e rezultateve të Atletit ose vazhdimin e pjesëmarrjes në Aktivitet.]

8.2 Juridiksioni i Panelit Disiplinor të FKK-së, Nënkomisioni Mjeko-Ligjor

8.2.1 Paneli Disiplinor i FKK-së, komision Mjeko-Ligjor, ka kompetencën të shqyrtojë dhe vendosë për të gjitha çështjet që rrjedhin nga çdo çështje që i paraqitet në pajtim me këta Rregulla Anti-Doping. Veçanërisht, Paneli Disiplinor i FKK-së, komisioni Mjeko-Ligjor, ka kompetencën të vendosë për Pasojat e Shkeljeve të Rregullit Antidoping që vendosen në pajtim me këta Rregulla Anti-Doping.

8.2.2 Asnjë vendim përfundimtar ose për Pasojat e Shkeljeve të Rregullit Antidoping të vendosura nga Paneli Disiplinor i FKK-së/Komisioni Mjeko-Ligjor, nuk priset, ndryshohet, konsiderohet i pavlefshëm nga asnjë gjykatë, Gjyqtar, organ apo subjekt tjetër shqyrtimi të ndryshëm nga Paneli i Apelit të FKK-së ose CAS-i për çdo shkak, duke përfshirë për shkak të një mangësie, parregullsie, mosveprimi ose shmangie nga procedurat e parashikuara në këto Rregulla Anti-Doping, me kusht që të mos ketë keqadministrim të drejtësisë.

8.3 Caktimi i Panelit Disiplinor të FKK-së, Komisioni Mjeko-Ligjor

8.3.1 FKK pas konsultimit me Ministrinë përgjegjëse për Sportin emëron Panelin e pavarur Kosovar Disiplinor Antidoping që përbëhet më poshtë:

- a) Një Kryetar dhe dy (2) Zëvendëskryetarë, secili prej të cilëve është operator ligjor prej jo më pak se pesë (5) vjetësh eksperiencë, dhe
- b) Tre (3) praktikientë mjekësorë prej jo më pak se pesë (5) vjet eksperiencë, dhe
- c) Tre (3) anëtarë shtesë, secili prej të cilëve është ose ka qenë administrator sporti ose Atlet,

Ku të gjithë emërohen mbi bazën që ata janë në gjendje të shqyrtojnë çështjet me drejtësi, panësi dhe në mënyrë të pavarur.

8.3.2 Çdo anëtar paneli emërohet për një afat prej 5 vjetësh.

8.3.3 Kryetari i Panelit Disiplinor të FKK-së/Komisioni Mjeko-Ligjor, ose në mungesë të tij/saj, Zëvendëskryetari, emëron tre (3) anëtarë nga paneli për të shqyrtuar dhe vendosur një çështje. Çdo panel i tillë përbëhet nga Kryetari ose një Zëvendëskryetar si kryetar i panelit të shqyrtimit, një anëtar si praktikient mjekësor dhe një administrator sporti ose anëtar Atlet.

8.3.4 Anëtarët e emëruar nuk kanë përfshirje të mëparshme me çështjen. Secili anëtar, pas emërimit, i deklaron kryetarit çdo rrethanë që mund të ndikojë paanësinë në lidhje me një prej palëve.

Një anëtar i emëruar nuk mund të caktohet për të njëjtën çështje në Komisionin Mjeko-Ligjor të Apelit për të njëjtën çështje.

8.3.5 Nëse një anëtar i panelit vdes ose dorëhiqet, FKK në konsultim me Ministrinë përgjegjëse të sportit mund të emërojë një Person të pavarur të jetë anëtar paneli për të mbushur vendin vakant. Personi i emëruar në këtë mënyrë emërohet për pjesën e mbetur të mandatit të anëtarit që ka lënë vendin bosh.

8.4 Shqyrtimi para Panelit Disiplinor, Komisioni Mjeko-Ligjor

8.4.1 Në pajtim me dispozitat e këtyre Rregullave Anti-Doping, Paneli Disiplinor I FKK-së/Komisioni Mjeko-Ligjor ka kompetencën për të rregulluar procedurat e tyre.

8.4.2 FKK-ja e paraqet çështjen kundër personit para Panelit Disiplinor të FKK-së/Komisioni Mjeko-Ligjor dhe, nëse kërkohet nga FKK-ja

8.4.3 Personi kundër të cilit hapet një çështje ka të drejtën t'i përgjigjet shkeljes së dyshuar të rregullit Antidoping dhe Pasojave përkatëse.

8.4.4 Mosndjekja e një seance nga një palë ose përfaqësuesi i saj pas njoftimit konsiderohet heqje dorë nga e drejta për seancën. Kjo e drejtë mund të rivendoset për shkaqe të arsyeshme.

8.4.5 Secila Palë ka të drejtën të përfaqësohet në seancë, me shpenzimet e vetë palës.

8.4.6 Secila palë ka të drejtën për një përkthyes në seancë, nëse konsiderohet e nevojshme nga paneli i shqyrtimit. Paneli i shqyrtimit përcakton identitetin dhe përgjegjësinë për shpenzimet e përkthyesit.

8.4.7 Secila palë në gjykim ka të drejtën të paraqesë prova, duke përfshirë të drejtën për të thirrur dhe pyetur dëshmitarët (në tagrin e Panelit të Shqyrtimit për të pranuar deklarime me telefon, deklarime me shkrim ose parashpresa, me faks, e-mail ose mjete të tjera).

8.4.8 Faktet në lidhje me shkeljet e rregullit Antidoping mund të përcaktohen nëpërmjet çdo mjeti të arsyeshëm, duke përfshirë pranimet. Paneli i Shqyrtimit mund të pranojë prova, duke përfshirë bisedat, që i konsideron të përshtatshme dhe ka të drejtën t'u kushtojë atë peshë për atë provë që e konsideron të përshtatshme.

8.4.9 Paneli i shqyrtimit mund të zgjasë ose shtyjë një seancë.

8.4.10 Paneli i shqyrtimit, me kërkesë të një prej palëve në gjykim ose kryesisht, para seancës mund t'u kërkojë një ose disa palëve në seancë, t'i paraqesin atij dhe/ose palëve të tjera në gjykim hollësi të mëtejshme të çështjes që duhet të paraqiten nga ajo palë në seancë, duke përfshirë cilët dëshmitarë ata duan të kërkojnë dhe kjo palë përmbush këtë udhëzim.

8.4.11 Seancat mund të regjistrohen dhe çdo regjistrim është në pronësi dhe mbahet nga FKK-ja.

8.5 Vendimet e Panelit Disiplinor, Komisionit Mjeko-ligjor

8.5.1 Diskutimet e panelit të shqyrtimit janë konfidenciale.

8.5.2 Çdo vendim pakice ose ndryshe shënohet tek shkaqet me shkrim. 36 Në rastin e një vendimi shumice, ky është vendimi i Panelit të shqyrtimit.

8.5.3 Vendimi i Panelit të shqyrtimit është me shkrim, me datë dhe i nënshkruar (unanimisht ose me shumicë) që përfshin arsyet e plota për vendimin dhe për çdo periudhë Papërshtatshmërie të vendosur, duke përfshirë (sipas rastit) një justifikim se pse nuk janë vendosur Pasojat më të mëdha potenciale.

8.5.4 Vendimi i Panelit të shqyrtimit i njoftohet nga FKK-ja Atletit ose Personit Tjetër, Klubi i tij/saj dhe Organizatat e Antidopingut me të drejtë të ankimit sipas nenit 13.2.3.

8.5.5 Vendimet e Panelit Disiplinor/Komisionit Mjeko-ligjor mund të ankimohen sipas parashikimit në Nenin 13 (Ankimet). Nëse ndaj vendimit nuk bëhet ankim, (a) nëse vendimi është, se është bërë një shkelje e rregullit anti-doping, vendimi Deklarohet Publikisht, sipas parashikimit në Nenit 14.3.2; por (b) nëse vendimi është, se nuk është shkelur një rregull anti-doping, vendimi Deklarohet Publikisht me pëlqimin e Atletit ose Personit tjetër që është subjekt i vendimit. FKK-ja bën përpjekje të arsyeshme për të marrë këtë pëlqim, dhe nëse merret vendimi, e Deklaron Publikisht vendimin në tërësinë e tij ose në atë formë të redaktuar që Atleti ose Personit tjetër jep pëlqimin. Parimet e parashikuara në Nenin 14.3.6 zbatohen në rastet kur kemi të bëjmë me një të Mitur.

8.6 Parimet për një Gjykim të Drejtë

Të gjitha seancat në pajtim me Nenin 8.1 ose 8.2 respektojnë parimet e mëposhtme:

- gjykim në kohë;
- një panel gjykues të paanshëm dhe të drejtë për të gjitha palët dhe në çdo kohë;
- të drejtën për t'u përfaqësuar me avokat me shpenzimet e Personit;
- të drejtën për t'u informuar në një mënyrë të drejtë dhe në kohë për shkeljen e rregullit Antidoping të afirmuar;
- të drejtën për t'u shprehur në lidhje me shkeljen e rregullit Antidopingtë menduar dhe Pasojat përkatëse;
- të drejtën e çdo pale për të paraqitur prova, duke përfshirë të drejtën për të thirrur dhe pyetur dëshmitarë (në varësi të diskrecionit të panelit gjykues për të pranuar dëshmi me telefon ose parashtrësia me shkrim);

- të drejtën e Personit për një përkthyes në seancë, ku paneli gjykses përcakton identitetin dhe përgjegjësinë për shpenzimet e përkthyesit;
- një vendim në kohë, me shkrim dhe i arsyetuar, duke përfshirë specifikisht një shpjegim të shkakut(eve) për një periudhë Pezullimi; dhe
- respektim për dinjitetin personal dhe jetën privatë të Personit.

8.7 Gjykimi i Vetëm para CAS-it

Çështjet që afirmojnë shkelje të rregullit Antidoping ndaj Atletëve të Nivelit Ndërkombëtar ose Atletëve të Nivelit Kombëtar, mund të shqyrtohet drejtpërdrejt në CAS, pa iu nënshtuar kërkesës për një gjykim paraprak, me pëlqimin e Atletit, FKK-së, WADA-s dhe çdo Organizatë tjetër Antidoping që do të kishte të drejtën e ankimit për një vendim të gjykitimit në shkallën e parë tek CAS.

[Koment për Nenin 8.7: Nëse të gjitha palët e identifikuar në këtë Nen janë të bindura që interesat e tyre do të jenë të mbrojtura në masën e mjaftueshme në një gjykim të vetëm, nuk është nevojshme të bëjnë shpenzime shtesë për dy gjykime. Një Organizatë Antidoping që kërkon të marrë pjesë në gjykimin e CAS-it si palë ose si vëzhgues mund ta kushtëzojë pëlqimin e saj për një gjykim të vetëm me dhënien e kësaj të drejte.]

NENI 9 SKUALIFIKIMI AUTOMATIK I REZULTATEVE INDIVIDUALE

Një shkelje e rregullit Antidoping në Sporte Individuale në lidhje me një analizë Brenda Garës shkakton automatikisht Skualifikimin e rezultateve të përfuara në atë Garë me të gjitha Pasojat përkatëse, duke përfshirë humbjen e çdo medaljeje, pikëve dhe çmimeve.

[Koment për Nenin 9: Për Sportet Ekipore, çdo çmim i marrë nga lojtarë individualë Skualifikohet. Megjithatë, Skualifikimi i ekipit bëhet sipas parashikimit në Nenin 11. Në sportet që nuk janë Sporte Ekipore, por që çmimet u jepen ekipeve, Skualifikimi ose masat e tjera disiplinore kundër ekipit kur një ose më shumë anëtarë të ekipit kanë kryer një shkelje të rregullit Antidoping parashikohet në rregullat e zbatueshme të Federatës Ndërkombëtare.]

NENI 10 SANKSIONET PËR INDIVIDËT

10.1 Skualifikimi i Rezultateve në Aktivitetin gjatë të cilit Ndodh një Shkelje e Rregullit Antidoping

Një shkelje e një rregulli Antidoping që ndodh gjatë ose në lidhje me një Aktivitet, me vendim të organit vendim-marrës për Aktivitetin, mund të shkaktojë Skualifikimin e të gjithë rezultateve individuale të Atletit të përfuara në atë Aktivitet me të gjitha Pasojat, duke

përfshirë humbjen e të gjitha medaljeve, pikëve dhe çmimeve, përveç kur parashikohet ndryshe në Nenin 10.1.1.

Faktorët që duhet të përfshihen për të shqyrtuar nëse do të Skualifikohen rezultate të tjera në një Aktivitet mund të përfshijnë, për shembull, seriozitetin e shkeljes së rregullit Antidoping të Atletit dhe nëse Atleti ka patur analiza negative në Gara të tjera.

[Komente për Nenin 10.1: Ndërsa Neni 9 Skualifikon rezultatet në një Garë të vetme në të cilën analizat e Atletit kanë dalë positive. Ky nen mund të çojë në Skualifikimin e të gjitha rezultateve në të gjitha garat gjatë Aktivitetit 9 (p.sh, gjitha garat që përcaktohen nga FKK Kombetare the Ndërkombëtare.)]

10.1.1 Nëse Atleti provon që ai ose ajo nuk ka Faj ose Neglizhencë për shkeljen, rezultatet individuale të Atletit në Garat e tjera nuk Skualifikohen, përveç kur rezultatet e Atletit në Gara të tjera të ndryshme nga Gara në të cilën ka ndodhur shkelja e rregullit Antidoping mund të jenë ndikuar nga shkelja e rregullit Antidoping nga Atleti.

10.2 Papërshtatshmëria në rastin e Pranisë, Përdorimit, Tentativës së Përdorimit ose Zotërimit të Substancave të Ndaluar ose Metodave të Ndaluar

Periudha e Papërshtatshmërisë e vendosur për një shkelje të Nenit 2.1, 2.2, ose 2.6 janë si më poshtë, duke iu nënshtruar uljes ose pezullimit të mundshëm sipas parashikimit në Nenet 10.4, 10.5 ose 10.6:

10.2.1 Periudha e Papërshtatshmërisë është katër vjet nëse:

10.2.1.1 Shkelja e rregullit Antidoping nuk ka të bëjë me një Substancë të Specifikuar, përveç kur Atleti ose Personi tjetër mund të vërtetojë që shkelja e rregullit Antidoping nuk ishte e qëllimshme.

10.2.1.2 Shkelja e rregullit Antidoping ka të bëjë me një Substancë të Specifikuar dhe Organizata Antidoping mund të vërtetojë që shkelja e rregullit Antidoping ishte e qëllimshme.

10.2.2 Nëse Neni 10.2.1 nuk zbatohet, afati i Papërshtatshmërisë është dy vjet.

10.2.3 Siç përdoret në Nenet 10.2 dhe 10.3, termi “i qëllimshëm” është për identifikimin e atyre Atletëve që gënjejnë. Kështu, termi kërkon që Atleti ose Personi tjetër i përfshirë në sjellje që ai ose ajo e dinte që përbënte një shkelje të rregullit Antidoping ose e dinte që kishte një rrezik të konsiderueshëm që sjellja mund të përbënte ose rezultonte në një shkelje të rregullit Antidoping dhe duket se e injoroi këtë rrezik. Një shkelje e rregullit Antidoping që rezulton nga një Konstatim Analitik Anormal për një substancë që ndalohet vetëm Brenda Garës, nëse nuk kundërshtohet, prezumohet të mos jetë “e qëllimshme” nëse substanca është një Substancë e Specifikuar dhe Atleti mund të vërtetojë që Substanca e Ndaluar është përdorur Jashtë Gare. Një shkelje e rregullit Antidoping që rrjedh nga një Konstatim Analitik Anormal për një substancë që ndalohet vetëm Brenda Garës nuk konsiderohet “e qëllimshme” nëse substanca

nuk është një Substancë e Specifikuar dhe Atleti mund të vërtetohet që Substanca e Ndaluar është përdorur jashtë Gare në një kontekst që nuk ka të bëjë me rezultatin në sport.

10.3 Papërshtatshmëria për Shkelje të Tjera të Rregullit Antidoping

Periudha e Papërshtatshmërisë për shkeljet e rregullit anti-doping, ndryshe nga sa parashikohet në Nenin 10.2, është si më poshtë, përveç kur është i zbatueshëm Neni 10.5 ose 10.6:

10.3.1 Për shkeljet e Nenit 2.3 ose Nenit 2.5, periudha e Papërshtatshmërisë do të jetë katër vjet përveç, në rastin e mosparaqitjes së Mostrës, Atleti mund të vërtetohet që kryerja e shkeljes së rregullit Antidoping nuk ishte e qëllimshme (sipas përkufizimit të Nenit 10.2.3), ku në këtë rast periudha e Papërshtatshmërisë do të jetë dy vjet.

10.3.2 Për shkeljet e Nenit 2.4, periudha e Papërshtatshmërisë do të jetë dy vjet, duke iu nënshtruar uljes në një minimum prej një vit, në varësi të shkallës së Fajit të Atletit. Fleksibiliteti ndërmjet dy vjetëve dhe një viti të Papërshtatshmërisë në këtë Nen nuk ofrohet për Atletët nëse një model i 40 ndryshimit të vendndodhjes në minutën e fundit ose sjellje tjetër ngre dyshime serioze që Atleti po përpiqej të shmangte disponibilitetin e tij për Analizat.

10.3.3 Për shkelje të Nenit 2.7 ose 2.8, periudha e Papërshtatshmërisë është minimalisht katër vjet deri në Papërshtatshmëri të përjetshme, në varësi të seriozitetit të shkeljes. Një shkelje e Nenit 2.7 ose Nenit 2.8 që ka të bëjë me një të Mitur konsiderohet një shkelje veçanërisht e rëndë dhe, nëse kryhet nga Personeli Mbështetës i Atletit për shkelje të ndryshme nga Substancat e Specifikuara, rezulton në pezullim të përjetshëm të Personelit Mbështetës të Atletit. Përveç kësaj, shkelje të konsiderueshme të Neneve 2.7 dhe 2.8, që mund të shkelin edhe ligjet dhe rregulloret jo-sportive, u raportohen autoriteteve administrative, profesionale ose gjyqësore.

[Koment për Nenin 10.3.3: Ata që përfshihen në dhënie të Dopingut Atletëve ose mbulimin e dopingut duhet t'u nënshtrohen sanksioneve më të forta se Atletet të cilëve u dalin analizat pozitive. Meqenëse autoriteti i organizatave sportive përgjithësisht kufizohet në Papërshtatshmëri për akreditim, anëtarësi dhe përfitime të tjera sportive, raportimi i Personelit Mbështetës të Atletit tek autoritetet kompetente është një hap i rëndësishëm në shmangien e Dopingut.]

10.3.4 Për shkeljet e Nenit 2.9, periudha e Papërshtatshmërisë është minimalisht dy vjet deri në katër vjet, në varësi të seriozitetit të shkeljes.

10.3.5 Për shkeljet e Nenit 2.10, periudha e Papërshtatshmërisë është dy vjet, duke iu nënshtruar uljes në minimalisht një vit, në varësi të shkallës së Fajit të Atletit ose Personit tjetër dhe rrethanave të tjera të çështjes.

[Koment për Nenin 10.3.5: Nëse "Personi tjetër" i përmendur në Nenin 2.10 është një subjekt dhe jo individ, ai subjekt mund të trajtohet sipas nenit 12.]

10.4 Eliminimi i Periudhës së Papërshtatshmërisë nëse Nuk ka Faj ose Neglizhencë

Nëse një Atlet ose Person tjetër mund të provojë në një rast të veçantë se ai ose ajo Nuk ka Faj ose Neglizhencë, periudha e Papërshtatshmërisë e zbatueshme eliminohet.

[Koment për Nenin 10.4: Ky Nen dhe Neni 10.5.2 zbatohen vetëm për vendosjen e sanksioneve; ata nuk janë të zbatueshëm për përcaktimin nëse ka ndodhur një shkelje e rregullit anti-doping. Ata zbatohen vetëm në rrethana të veçanta, për shembull, nëse një atlet mund të provonte që, megjithë kujdesin e duhur, ai ose ajo është sabotuar nga një konkurrent. Nga ana tjetër, Mospasja e Fajit ose Neglizhencës nuk do të zbatohen në rrethanat e mëposhtme: (a) një analizë pozitive që rrjedh nga një vitaminë me etiketë të gabuar ose e kontaminuar ose suplemente ushqimore (Atletët janë përgjegjës për atë që ata konsumojnë (Neni 2.1.1) dhe janë paralajmëruar për mundësinë e kontaminimit të suplementeve); (b) Administrimi i një Substance të Ndaluar nga mjeku ose trajneri personal i Atletit pa ia treguar Atletit (Atletët janë përgjegjës për zgjedhjen e personelit mjekësor të tyre dhe për këshillimin e personelit mjekësor që atyre nuk mund t'u jepet asnjë Substance e Ndaluar); dhe (c) sabotimi i ushqimit ose pijeve të Atletit nga një bashkëshort, trajner, ose Person tjetër brenda rrethit të bashkëpunëtorëve të Atletit (Atletët janë përgjegjës për atë që ata konsumojnë dhe për sjelljen e atyre Personave të cilëve ata u besojnë aksesin në ushqimin dhe pijet e tyre). Megjithatë, në varësi të fakteve unike të një çështjeje të caktuar, secili prej ilustrimeve të përmendura mund të rezultonte në një sanksion të zbatuar sipas Nenit 10.5 bazuar në Mospasjen e Fajit ose Neglizhencës së Konsiderueshme.]

10.5 Shkurtimi i Periudhës së Papërshtatshmërisë bazuar në Mospasjen e Fajit ose Neglizhencës së Konsiderueshme

10.5.1 Ulja e Sanksioneve për Substancat e Specifikuara ose Produktet e Kontaminuara për Shkeljet e Nenit 2.1, 2.2 ose 2.6.

Nëse një shkelje e rregullit Antidoping ka të bëjë me një Substancë të Specifikuar dhe Atleti ose Personi tjetër mund të vërtetojë Mungesën e Fajit ose Neglizhencës së Konsiderueshme, afati i Papërshtatshmërisë është minimalisht një vërejtje dhe pa afat Papërshtatshmërie dhe maksimalisht dy vjet Papërshtatshmëri, në varësi të shkallës së Fajit të Atletit ose Personit tjetër.

10.5.1.2 Produktet e Kontaminuara

Nëse Atleti ose Personi tjetër mund të vërtetojë Mungesën e Fajit ose Neglizhencës së Konsiderueshme dhe Substanca e Ndaluar e zbuluar ka ardhur nga një Produkt i Kontaminuar, afati i Papërshtatshmërisë është minimalisht një vërejtje dhe pa afat Papërshtatshmërie dhe maksimalisht dy vjet Papërshtatshmëri, në varësi të shkallës së Fajit të Atletit ose Personit tjetër.

[Koment për Nenin 10.5.1.2: Në vlerësimin e shkallës së fajit të Atletit, do të ishte, për shembull, e favorshme për Atletin nëse Atleti ka deklaruar produktin, i cili më vonë është vendosur të jetë kontaminuar, në formularin e tij ose të saj të Kontrollit të Dopingut.]

10.5.2 Zbatimi i Mungesës së Fajit ose Neglizhencës së Konsiderueshme tej zbatimit të Nenit 10.5.1

Nëse Atleti ose Personi tjetër provon në një rast të veçantë, ku Neni 10.5.1 nuk është i zbatueshëm, që ai ose ajo nuk ka Faj ose Neglizhencë të Konsiderueshme, duke iu nënshtuar uljes së mëtejshme ose eliminimit sipas parashikimit në Nenin 10.6, afati i zbatueshëm i Papërshtatshmërisë mund të ulet bazuar në shkallën e Fajit të Atletit ose Personit tjetër, por afati i ulur i Papërshtatshmërisë nuk mund të jetë më pak se një e dyta e afatit të Papërshtatshmërisë që zbatohet përndryshe. Nëse afati i zbatueshëm i Papërshtatshmërisë është i përhershëm, afati i ulur sipas këtij neni nuk mund të jetë më pak se tetë vjet.

[Koment për Nenin 10.5.2: Neni 10.5.2 mund të zbatohet për çdo shkelje të rregullit anti-doping, përveç atyre Neneve ku qëllimshmëria është një element i shkeljes së rregullit Antidoping (p.sh., Neni 2.5, 2.7, 2.8 ose 2.9) ose një element i një sanksioni të caktuar (p.sh., Neni 10.2.1) ose një masë Papërshtatshmërie është parashikuar në një Nen bazuar në shkallën e Fajit të Atletit ose Personit tjetër.]

10.6 Eliminimi, Shkurtimi ose Pezullimi i Afatit të Papërshtatshmërisë ose Pasoja të tjera për Shkaqe të ndryshme nga Faji

10.6.1 Ndhimë Thelbësore në Zbulimin ose Vërtetimin e Shkeljeve Antidoping

10.6.1.1 Një Organizatë Antidoping me përgjegjësi për menaxhimin e rezultateve për një shkelje të rregullit anti-doping, para një vendimi përfundimtar apeli sipas Nenit 13 ose skadimit të afatit të ankimit, mund të pezullojë një pjesë të afatit të Papërshtatshmërisë të vendosur në një rast të veçantë nëse Atleti ose Personi tjetër ka dhënë Ndhimë Thelbësore për një Organizatë Anti-Doping, autoritet të ndjekjes penale ose organ profesional disiplinor që rezulton në: (i) zbulimin nga Organizata Antidoping ose paraqitjen e një shkeljeje Antidoping nga një Person tjetër, ose (ii) që rezulton në zbulimin nga një organ i ndjekjes penale ose disiplinore ose që paraqet një vepër penale ose shkelje të rregullave profesionale të kryer nga një Person tjetër dhe informacioni i dhënë nga Personi që jep Ndhimën Thelbësore i jepet Organizatës Antidoping me përgjegjësi për menaxhimin e rezultateve. Pas një vendimi përfundimtar apeli sipas Nenit 13 ose skadimit të afatit për të bërë ankim, një Organizatë Antidoping mund të pezullojë vetëm një pjesë të afatit të zbatueshëm të Papërshtatshmërisë me aprovimin e WADA-s dhe Federatës përkatëse Ndërkombëtare. Masa në të cilën afati i zbatueshëm i Papërshtatshmërisë mund të pezullohet bazohet në seriozitetin e shkeljes së rregullit Antidoping të kryer nga Atleti ose Personi tjetër dhe rëndësinë e Ndhimës Thelbësore të dhënë nga Atleti ose Personi tjetër në përpjekjen për të eliminuar dopingun në sport. Nuk mund të pezullohet më shumë se tre të katërtat e afatit të zbatueshëm të Papërshtatshmërisë. Nëse afati

i zbatueshëm i Papërshtatshmërisë është i përjetshëm, afati i papezulluar sipas këtij Neni duhet të jetë jo më pak se tetë vjet. Nëse Atleti ose Personi tjetër nuk vazhdon të bashkëpunojë dhe të japë Ndihmën Thelbësore të plotë dhe të besueshme në të cilën bazohet pezullimi i afatit të Papërshtatshmërisë, Organizata Antidoping që ka pezulluar afatin e Papërshtatshmërisë e rivendos afatin fillestar të Papërshtatshmërisë. Nëse një Organizatë Antidopingvendos të rivendosë afatin e pezulluar të Papërshtatshmërisë ose vendos të mos rivendosë një afat të pezulluar të Papërshtatshmërisë, ky vendim mund të ankimohet nga çdo Person që ka të drejtën e ankimit sipas Nenit 13.

10.6.1.2 Për të inkurajuar më tej Atletët dhe Personat e tjerë t'u japin Ndihmë Thelbësore Organizatave Anti-Doping, me kërkesë të Organizatës Antidoping që kryhen menaxhimin e rezultateve ose me kërkesë të Atletit ose Personit tjetër i cili është ose ka qenë treguar se ka kryer një shkelje të rregullit anti-doping, WADA mund të bjerë dakord në çdo fazë të procesit të menaxhimit të rezultateve, duke përfshirë pas një vendimi përfundimtar apeli sipas Nenit 13, për atë që ajo e konsideron si pezullim të përshtatshëm të periudhës së zbatueshme të Papërshtatshmërisë dhe Pasojave të tjera. Në rrethana të veçanta, WADA mund të bjerë dakord me pezullimet e periudhës së Papërshtatshmërisë dhe pasojave të tjera për Asistencën Thelbësore më të gjata se ato të parashikuara në këtë Nen, ose edhe pa afat Papërshtatshmërie, dhe/ose pa kthim të parave të çmimit ose pagesën e gjobave ose shpenzimeve. Aprovimi i WADA-s i nënshtrohet rivendosjes së sanksionit, siç parashikohet përndryshe në këtë Nen. Pavarësisht Nenit 13, vendimet e WADA-s në kontekstin e këtij Neni nuk mund të ankimohen nga një Organizatë Antidoping tjetër.

10.6.3 Pranimi i menjëhershëm i një Shkeljeje të Rregullit Antidoping pas Përballjes me një Shkelje të Sanksionueshme sipas Nenit 10.2.1 ose Nenit 10.3.1

Një Atlet ose Person tjetër që mund t'i nënshtrohet një sanksioni katër-vjeçar sipas Nenit 10.2.1 ose 10.3.1 (për shmangien ose refuzimin e Marrjes së Mostrës ose Manipulimin e Marrjes së Mostrës), duke pranuar menjëherë shkeljen e treguar të rregullit Antidoping pas konfrontimit me një Organizatë Anti-Doping, dhe gjithashtu me aprovimin dhe në diskrecionin e WADA-s dhe Organizatës Antidoping me përgjegjësi për menaxhimin e rezultateve, mund të marrë një shkurtim të periudhës së Papërshtatshmërisë deri në një minimum prej dy vjetësh, në varësi të seriozitetit të shkeljes dhe shkallës së Fajit të Atletit ose Personit tjetër.

10.6.4 Zbatimi i Disa Shkaqeve për Uljen e Sanksionit

Nëse një Atlet ose Person tjetër vërteton të drejtën e uljes së sanksionit sipas më shumë se një dispozite të Nenit 10.4, 10.5 ose 10.6, para zbatimit të një uljeje ose pezullimi sipas Nenit 10.6, afati i zbatueshëm i Papërshtatshmërisë përcaktohet në pajtim me Nenet 10.2, 10.3, 10.4 dhe 10.5. Nëse Atleti ose Personi tjetër vërteton të drejtën për një shkurtim ose pezullim të afatit të Papërshtatshmërisë sipas Nenit 10.6, afati i Papërshtatshmërisë mund të shkurtohet ose pezullohet, por jo më poshtë një të katërtës së afatit të zbatueshëm të Papërshtatshmërisë.

[Koment për Nenin 10.6.4: Sanksioni i përshtatshëm përcaktohet në vazhdim të katër hapave. Së pari, paneli i gjyqimit vendos cili nga sanksionet bazë (Neni 10.2, 10.3, 10.4 apo 10.5) zbatohet për shkeljen përkatëse të rregullit anti-doping. Së dyti, Nëse sanksioni bazë parashikon një gamë sanksionesh, paneli i gjyqimit duhet të përcaktojë sanksionin e zbatueshëm brenda gamës sipas shkallës së Fajit të Atletit ose Personit tjetër. Në një hap të tretë, paneli i gjyqimit vendos nëse ka një bazë për eliminimin, pezullimin ose uljen e sanksionit (Neni 10.6). Së fundmi, paneli i gjyqimit vendos mbi fillimin e afatit të Papërshtatshmërisë sipas Nenit 10.11. Në Shtojcën 2 gjenden disa shembuj se si zbatohet Neni 10.]

10.7 Disa Shkelje

10.7.1 Për shkeljen e dytë Antidoping të një Atleti ose Personi tjetër, periudha e Papërshtatshmërisë do të jetë më e madhe se:

(a) gjashtë muaj;

(b) gjysma e afatit të Papërshtatshmërisë të vendosur për shkeljen e parë të rregullit Antidoping pa marrë parasysh asnjë ulje sipas Nenit 10.6; ose

(c) dyfishi i afatit të Papërshtatshmërisë që zbatohet për shkeljen e dytë të rregullit Antidoping që trajtohet sikur të ishte një shkelje e parë, pa marrë parasysh asnjë ulje sipas Nenit 10.6.

Afati i Papërshtatshmërisë i vendosur më sipër mund të shkurtohet më tej duke zbatuar Nenin 10.6.

10.7.2 Një shkelje e tretë e rregullit Antidoping do të rezultojë gjithmonë në një periudhë të përhjetshme Papërshtatshmërie, përveç kur shkelja e tretë përmbush kushtet për eliminimin ose uljen e periudhës së Papërshtatshmërisë sipas Nenit 10.4 ose 10.5 ose përfshin një shkelje të nenit 2.4. Në këto raste të veçanta, periudha e Papërshtatshmërisë është nga tetë vjet deri në Papërshtatshmëri të përhjetshme.

10.7.3 Një shkelje e rregullit Antidoping për të cilën një Atlet ose Person ka vërtetuar Mungesën e Fajit ose Neglizhencës nuk konsiderohet shkelje e mëparshme për qëllimet e këtij Neni.

10.7.4 Rregulla Shtesë për Disa Shkelje të Caktuara të Mundshme

10.7.4.1 Për qëllimet e vendosjes së sanksioneve sipas Nenit 10.7, një shkelje e rregullit Antidoping do të konsiderohet shkelje e dytë e rregullit Antidoping nëse Organizata Antidoping mund të provojë që Atleti ose Personi tjetër ka kryer shkeljen e dytë të rregullit Antidoping pasi Atleti ose Personi tjetër ka marrë njohim në pajtim me Nenin 7, ose pasi Organizata Antidoping ka bërë përpjekje të arsyeshme për të bërë njohim për shkeljen e parë të rregullit anti-doping. Nëse Organizata Antidoping nuk mund ta provojë këtë, shkeljet konsiderohen së bashku si një shkelje e parë e veprime dhe sanksionet e caktuara bazohen në shkeljen që ka sanksionin më të ashpër.

10.7.4.2 Nëse, pas vendosjes së sanksionit për shkeljen e parë të rregullit anti-doping, një Organizatë Antidoping zbulon fakte në lidhje me një shkelje të rregullit Antidoping nga Atleti ose Personi tjetër që ka ndodhur para njoftimit në lidhje me shkeljen e parë, Organizata Antidopingvendos një sanksion shtesë të bazuar në sanksionin që mund të caktohet nëse të dy shkeljet do të ishin gjykuar në të njëjtën kohë. Rezultatet në të gjitha Garat që janë të një date më parë se shkelja e parë e rregullit Antidoping do të Skualifikohen sipas parashikimit të Nenit 10.8.

10.7.5 Disa Shkelje të Rregullit Antidoping Gjatë një Periudhe dhjetë-Vjeçare

Për qëllimet e Nenit 10.7, çdo shkelje e rregullit Antidopingduhet të ndodhë brenda të njëjtës periudhë dhjetë-vjeçare me qëllim që të konsiderohen si disa shkelje.

10.8 Skualifikimi i Rezultateve në Garat Pas Marrjes së Mostrave ose Kryerjes së një Shkeljeje të Rregullit Antidoping

Përveç Skualifikimit automatik të rezultateve në Garën që nxori Mostrën pozitiv sipas Nenit 9, të gjitha rezultatet e tjera në gara të marra nga data në të cilën u mor mostra pozitiv (qoftë Brenda Garës apo Jashtë Garës), ose nga ndodhia e shkeljes së rregullit tjetër anti-doping, nëpërmjet fillimit të një periudhe të Pezullimit Provizor ose të Papërshtatshmërisë, përveç kur drejtësia e kërkon ndryshe, Skualifikohen me të gjitha Pasojat përkatëse duke përfshirë humbjen e çdo medaljeje, pikëve dhe çmimeve.

10.9 Allokimi i kostos dhe Shpenzimeve të CAS-it dhe Fitimeve të tërhequra

Prioriteti për shlyerjen e shpenzimeve e CAS-it dhe fitimeve të tërhequra është: së pari, pagesa e shpenzimeve të bëra nga CAS-i; së dyti, riallokimi i parave për fitimet e tërhequra tek Atletët e tjerë nëse kjo parashikohet në rregullat e Federatës Ndërkombëtare përkatëse; dhe së treti, rimbursimi i shpenzimeve të Organizatës Anti-Doping.

10.10 Pasojat Financiare

Nëse një Atlet ose një Person tjetër kryhen një shkelje të rregullit anti-doping, FKK-ja, në diskrecionin e saj dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, zgjedh të a) përfitojë nga Atleti ose Personi tjetër shpenzime në lidhje me shkeljen e rregullit anti-doping, pavarësisht nga periudha e Papërshtatshmërisë së caktuar 47 dhe/ose b) gjobit Atletin ose Personin tjetër, vetëm në rastet kur periudha maksimale e Papërshtatshmërisë përndryshe e zbatuar është vendosur

Vendosja e një sanksioni financiar ose përfilimi i shpenzimeve nga FKK-ja nuk konsiderohet si bazë për uljen e Papërshtatshmërisë ose sanksionit tjetër që do të ishte i zbatueshëm sipas këtyre Rregullave Antidoping ose Kodit.

10.11 Fillimi i Periudhës së Papërshtatshmërisë

Përveç kur parashikohet më poshtë, periudha e Papërshtatshmërisë fillon në datën e vendimit të gjykimit që parashikon Papërshtatshmërinë ose, nëse nga gjykimi hiqet dorë, në datën që pranohet ose vendoset Papërshtatshmëria.

10.11.1 Vonesat Jo për Shkak të Atletit apo Personit tjetër

Nëse ka patur vonesa thelbësore në procesin e gjykimit apo aspekte të tjera të Kontrollit të Dopingut jo për shkak të Atletit ose Personit tjetër, organi që vendos sanksionin mund të fillojë periudhën e Papërshtatshmërisë në një datë të mëparshme që fillon që në datën e marrjes së Mostrave ose në datën në të cilën ka ndodhur së fundi shkelja e rregullit anti-doping. Të gjitha rezultatet e garave që janë marrë gjatë periudhës së Papërshtatshmërisë, duke përfshirë Papërshtatshmërinë me prapaveprim, skualifikohen.

[Koment për Nenin 10.11.1: Në rastet e shkeljeve të rregullit Antidoping të ndryshme nga ato sipas Nenit 2.1, afati i kërkuar për një Organizatë Antidopingpër të zbuluar dhe zhvilluar fakte të mjaftueshme për të vërtetuar një shkelje të rregullit Antidoping mund të jetë i gjatë, veçanërisht nëse Atleti ose Personi tjetër ka ndërmarë veprim aktiv për të shmangur zbulimin. Në këto rrethana, fleksibiliteti i parashikuar në këtë Nen për fillimin e sanksionit në një datë më të mëparshme nuk duhet të aplikohet.]

10.11.2 Pranimi në Kohë

Nëse Atleti ose Personi tjetër pranon menjëherë (që, në çdo rast, për një Atlet do të thotë para se Atleti të marrë pjesë përsëri në garë) pranon shkeljen e rregullit Antidoping pasi të jetë përballur me shkeljen e rregullit Antidopingnga Organizata Anti-Doping, periudha e Papërshtatshmërisë mund të fillojë që në datën e marrjes së Mostrave ose në datën në të cilën ka ndodhur së fundi një shkelje tjetër e rregullit anti-doping. Megjithatë, në çdo rast, kur zbatohet ky Nen, Atleti ose Personi tjetër vuan të paktën gjysmën e periudhës së Papërshtatshmërisë që mbetet nga data që Atleti ose Personi tjetër ka pranuar caktimin e sanksionit, data e një vendimi gjykimi që cakton një sanksion ose data që sanksioni është vendosur. Ky Nen nuk zbatohet nëse afati i Papërshtatshmërisë është shkurtuar sipas Nenit 10.6.3.

10.11.3 Kompensimi për Pezullimin e Përkohshëm ose Periudhën e Papërshtatshmërisë së Shërbyer

10.11.3.1 Nëse vendoset një Pezullim i Përkohshëm dhe respektohet nga Atleti, Atleti përfton kompensim për këtë periudhë të Pezullimit të Përkohshëm kundrejt çdo periudhe Pezullimi që mund të vendoset përfundimisht. Nëse një periudhë Papërshtatshmërie kryehet në pajtim me një vendim që ankimohet më vonë, atëherë Atleti ose Personit tjetër merr një kompensim për këtë periudhë Papërshtatshmërie të shërbyer kundrejt çdo periudhe Papërshtatshmërie që atij mund t'i caktohet pas ankimit.

10.11.3.2 Nëse një Atlet ose Person tjetër pranon vullnetarisht një Pezullim të Përkohshëm me shkrim nga një Organizatë Antidoping me autoritet për menaxhimin e rezultateve dhe pas kësaj ai e respekton Pezullimin e Përkohshëm, Atleti ose Personi tjetër merr një kompensim për këtë periudhë të Pezullimit të Përkohshëm vullnetar ndaj çdo periudhe Papërshtatshmërie që mund të vendoset përfundimisht. Një kopje e pranimi vullnetar të Atletit ose Personit tjetër të Pezullimit të Përkohshëm i paraqitet menjëherë çdo pale që ka të drejtë të marrë njofim për një shkelje të dhënë të rregullit Antidoping sipas Nenit 14.1

[Koment për Nenin 10.11.3.2: Një pranim vullnetar i një Atleti të një Pezullimi të Përkohshëm nuk është një pranim nga Atleti dhe nuk përdoret në mënyrë që të tërhiqet një konkluzion negative kundër Atletit.]

10.11.3.3 Nuk jepet kompensim ndaj një periudhe Papërshtatshmërie për asnjë periudhë para datës së fillimit të Pezullimit të Përkohshëm ose Pezullimit të Përkohshëm vullnetar pavarësisht nëse Atleti ka zgjedhur për të mos marrë pjesë në garë ose është pezulluar nga ekipi i tij ose i saj.

10.11.3.4 Në Sportet Ekipore, nëse një periudhë Papërshtatshmërie vendoset për një ekip, nëse drejtësisht nuk e kërkon ndryshe, periudha e Papërshtatshmërisë fillon në datën e vendimit përfundimtar nga gjykimi i cili përcakton Papërshtatshmërinë ose, nëse hiqet dorë nga gjykimi, në datën që Papërshtatshmëria pranohet ose vendoset ndryshe. Çdo periudhë e Pezullimit të Përkohshëm (i vendosur apo i pranuar vullnetarisht) kompensohet kundrejt periudhës së plotë të Papërshtatshmërisë që duhet të vuhet.

[Koment për Nenin 10.11: Neni 10.11 e bën të qartë që vonesat që nuk i atribuohen Atletit, pranimi në kohë nga Atleti dhe Pezullimi i Përkohshëm janë të vetmit justifikime për fillimin e periudhës së Papërshtatshmërisë më parë se data e vendimit përfundimtar të gjyqimit]

10.12 Statusi gjatë Papërshtatshmërisë

10.12.1 Ndalimi ndaj Pjesëmarrjes gjatë Papërshtatshmërisë

Asnjë Atlet ose Person tjetër që është deklaruar i Papërshtatshëm, gjatë periudhës së Papërshtatshmërisë nuk mund të marrë pjesë në asnjë cilësi në një Garë ose aktivitet (të ndryshme nga programet e autorizuara të edukimit dhe rehabilitimit anti-doping) të autorizuar ose organizuar nga një Nënshkrues, organizata anëtare e Nënshkruesit ose një klub apo organizatë tjetër anëtare e një organizatë anëtare e Nënshkruesit, ose në Garat e autorizuara ose organizuara nga një lidhje profesionale ose një organizatë e një Aktiviteti të nivelit ndërkombëtar ose kombëtar, ose në një aktivitet sportiv elitë ose të nivelit kombëtar të financuar nga një agjenci qeveritare.

Një Atlet ose Person tjetër që i nënshtrohet një periudhe Pavlefshmërie jo më shumë se katër vjet, pas kalimit të katër viteve të periudhës së Papërshtatshmërisë, mund të marr pjesë si Atlet

në aktivitet lokale sportive që nuk janë sanksionuar ose ndryshe nën juridiksionin e Nënshkruesit të Kodit ose anëtarit të Nënshkruesit të Kodit, por vetëm në masën që ngjarja sportive lokale nuk është në një nivel që mund të kualifikojë këtë Atlet ose Person tjetër drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt për të marrë pjesë (ose të mbledhë pikë për) në kampionate kombëtare ose Aktivitete Ndërkombëtare, dhe nuk e angazhon Atletin ose Personin tjetër të punojë në ndonjë cilësi me të Miturit.

Një Atlet ose Person tjetër që i nënshtrohet një periudhe Papërshtatshmërie mbetet i detyruar për të bërë Analizat.

[Komenti për Nenin 10.12.1: Për shembull, Në pajtim me Nenin 10.12.2 më poshtë, një Atlet i Papërshtatshëm nuk mund të marr pjesë në një kamp trajnimi, shfaqje apo praktikë të organizuar nga Federata e tij ose e saj Kombëtare apo një klub që është anëtar i asaj Federate Kombëtare, ose që financohet nga një agjenci qeveritare. Për më tepër, një Atlet i Papërshtatshëm nuk mund të marr pjesë në garë në një lidhje profesionale jo-Nënshkruese. Aktivitetet e organizuara nga një organizatë joNënshkruese e një Aktiviteti Ndërkombëtar ose një organizatë jonënshkruese e një aktiviteti të nivelit kombëtar pa pësuar Pasojat e parashikuara në Nenin 10.10.3. Termi “aktivitet” përfshin gjithashtu, për shembull, aktivitetet administrative, si puna si punonjës, drejtor, nëpunës, i punësuar ose vullnetar i organizatës së përshkruar në këtë Nen. Papërshtatshmëria e vendosur në një sport njihet gjithashtu nga sportet e tjera (shih Nenin 15.1 Njohja Reciproke.)

10.12.2 Kthimi në Trajnim

Si përjashtim i Nenit 10.12.1, Atleti mund të kthehet të trajnohet me ekipin ose të përdorë mjediset e një klubi ose organizate tjetër anëtare të organizatës anëtare të Nënshkruesit gjatë periudhës më të shkurtër të: (1) dy muajt e fundit të periudhës së Papërshtatshmërisë së Atletit, ose (2) semestri i fundit i periudhës së Papërshtatshmërisë së vendosur.

[Koment për Nenin 10.12.2: Në shumë Sporte Ekipore dhe disa sporte individuale, një Atlet nuk mund të trajnohet me efektivitet vetë për të qenë i gatshëm për të konkuruar me përfundimin e periudhës së Papërshtatshmërisë të Atletit. Gjatë periudhës së trajnimit të përshkruar në këtë nen, Atleti i Papërshtatshëm nuk mund të marrë pjesë në garë ose të angazhohet në ndonjë aktivitet të përshkruar në Nenin 10.12.1 të ndryshëm nga trajnimi.]

10.12.3 Shkelja e Ndalimit të Pjesëmarrjes Gjatë Papërshtatshmërisë

Nëse një Atlet ose Person tjetër që është deklaruar i Papërshtatshëm shkel ndalimin e pjesëmarrjes gjatë Papërshtatshmërisë së parashikuar në Nenin 10.12.1, rezultatet e kësaj pjesëmarrjeje Skualifikohen dhe shtohet një periudhë e re e Papërshtatshmërisë e barabartë në gjatësi me periudhën fillestare të Papërshtatshmërisë. Periudha e re e Papërshtatshmërisë mund të përshtatet bazuar në shkallën e Fajit të Atletit ose Personit tjetër ose rrethana të tjera të çështjes. Përeaktimi nëse një Atlet ose Person tjetër ka shkelur ndalimin kundër pjesëmarrjes, dhe nëse një përshtatje është e përshtatshme, bëhet nga Organizata Antidoping menaxhimi i

rezultateve të së cilës ka çuar në vendosjen e periudhës fillestare të Papërshtatshmërisë. Ky vendim mund të ankimohet sipas Nenit 13.

Nëse një Person Mbështetës i Atletit ose Person tjetër ndihmon një Person në shkeljen e ndalimit ndaj pjesëmarrjes gjatë Papërshtatshmërisë, një Organizatë Antidoping me juridiksion mbi këtë Person Mbështetës të Atletit ose Person tjetër mund të vendosë sanksione për shkeljen e Nenit 2.9 për një ndihmë të tillë.

10.12.4 Mosdhënia e Mbështetjes Financiare gjatë Papërshtatshmërisë

Përveç kësaj, për çdo shkelje të rregullit Antidoping që nuk ka të bëjë me një sanksion të ulur sipas parashikimit në Nenin 10.4 ose 10.5, një pjesë ose e gjithë mbështetja financiare për sportin apo përfitime të tjera për sportin që merren nga ky person mbahen nga Nënshkruesit, organizatat anëtare të Nënshkruesve dhe qeveritë.

10.13 Publikimi Automatik i Sanksionit

Një pjesë detyruese e çdo sanksioni konsiston në publikimin automatik, sipas parashikimit në Nenin 14.3.

[Koment për Nenin 10: Harmonizimi i sanksioneve ka qenë një nga segmentet më të diskutuara dhe të debatuarat të anti-dopingut. Harmonizim do të thotë që të njëjtët rregulla dhe kritere të zbatohen për të vlerësuar faktet unike për çdo rast. Argumentet kundër kërkesës së harmonizimit të sanksioneve bazohen në diferencat ndërmjet sporteve duke përfshirë, për shembull, sa më poshtë: në disa sporte Atletët janë profesionistë dhe përftojnë të ardhura të konsiderueshme nga sporti dhe në të tjerë Atletët janë amatorë të vërtetë; në ato sport ku karriera e një atleti është e shkurtër, periudha standarde e Papërshtatshmërisë ka një efekt tepër më të konsiderueshëm për atletin se në sportet ku karrierat tradicionalisht janë më të gjata. Një argument kryesor në favor të harmonizimit është se nuk është e drejtë që dy Atletë nga i njëjti vend të cilët dalin me analiza pozitive për të njëjtën Substancë të Ndaluar në të njëjta rrethana të marrin sanksione të ndryshme vetëm sepse ata marrin pjesë në sporte të ndryshme. Përveç kësaj, fleksibiliteti në vendosjen e sanksioneve është parë shpesh si një mundësi e papranueshme për disa organizata sportive të jenë më të buta me përdoruesit e dopingut. Mungesa e harmonizimit të sanksioneve shpesh ka qenë burimi i konflikteve juridiksionale ndërmjet Federatave Ndërkombëtare dhe Organizatave Kombëtare anti-Doping.]

NENI 11 PASOJAT PËR EKIPET

11.1 Analizat në Sportet në Ekipe

Nëse më shumë se një anëtar i një ekipi në një Sport Ekipo është njoftuar për një shkelje të rregullit Antidoping sipas Nenit 7 në lidhje me një aktivitet, organi vendim marrës i Aktivitetit kryen një Analizë të përshtatshme me Objektiv për ekipin gjatë Periudhës së Aktivitetit.

11.2 Pasojat për Sportet Ekipore.

Nëse më shumë se dy anëtarë të një ekipi ose gare ekipore konstatohen të kenë kryer një shkelje të rregullit Antidoping gjatë Periudhës së Aktivitetit, organi vendim-marrës i Aktivitetit vendos një sanksion të përshtatshëm mbi ekipin (p.sh. humbja e pikëve, Skualifikimi nga një Garë ose Aktivitet, ose sanksion tjetër) përveç Pasojave të vendosura mbi Atletët individualë që kanë kryer shkeljen e rregullit anti-doping.

11.3 Organi Vendim-Marrës i Aktivitetit mund të Vendosë Pasoja më të Ashpra për Sportet Ekipore

Organi vendim-marrës për një Aktivitet mund të zgjedhë të vendosë rregulla për Aktivitetin që përmbajnë Pasoja për Sportet Ekipore më të ashpra se ato të Nenit 11.2 për qëllimet e Aktivitetit.

[Komenti për Nenin 11.3: Për shembull, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar mund të vendosë rregulla që do të kërkonin Skualifikimin e ekipit nga Lojërat Olimpikë bazuar në një numër më të vogël të shkeljeve të rregullave Antidoping gjatë periudhës së Lojërave.]

NENI 12 SANKSIONET DHE KOSTOT E VLËSUARA NDAJ ORGANEVE SPORTIVE

12.1 FKK-ja mund të përfshijë dispozita për të vendosur sanksione për Klubet Antare mbi të cilat FKK-ja ka autoritet.

12.1.2 FKK-ja ka autoritet t'u ndalojnë Kulbeve antare përkatëse një pjesë ose të gjithë financimin ose mbështetjen tjetër jo-financiare nese Klubeve Antare nuk janë në pajtim me keto Rregulla të Anti-Dopong-u.

NENI 13 ANKIMET

13.1 Vendimet që mund të apeloohen

Vendimet e marra në bazë të Kodit ose rregullave të miratuara në pajtim me Kodin mund të ankimohen sipas parashikimit të mëposhtëm në Neneve 13.2 deri 13.7 ose siç parashikohet ndryshe në Kod ose Standardet Ndërkombëtare. Këto vendime mbeten në fuqi gjatë ankimimit, përveç kur organi i ankimimit urdhëron ndryshe. Para se të bëhet ankimi, duhet të shterohet çdo rishikim pas vendimit i parashikuar në rregullat e Organizatës Anti-Doping, me kusht që këto rishikime të respektojnë parimet e parashikuara në Nenin 13.2.2 më poshtë (përveç kur parashikohen ndryshe në Nenin 13.1.3).

13.1.1 Fusha e Rishikimit nuk është e kufizuar

Fusha e rishikimit për ankimet përfshin të gjitha çështjet që kanë rëndësi për rastin dhe shprehimisht nuk është i kufizuar tek çështjet ose fusha e rishikimit para vendim-marrësit fillestar.

13.1.2 CAS nuk do t'u referohet gjetjeve që apelohe

13.2 Ankimet kundër Vendimeve në Lidhje me Shkeljet e Rregullit AntiDoping, Pasojat, Pezullimet Provizore, Njohja e Vendimeve dhe Juridiksioni

Një vendim që konstaton kryerjen e një shkeljeje anti-doping, një vendim që vendos Pasoja ose që nuk vendos Pasoja për një shkelje të rregullit anti-doping, 54 ose një vendim që konstaton që nuk është kryer shkelje e rregullit anti-doping; një vendim që nuk mund të zhvillohet një procedim për një shkelje e rregullit Antidoping për arsye procedurale (duke përfshirë, për shembull, parashkrimin); një vendim nga WADA për të mos dhënë një përjashtim për kërkesën e njoftimit gjashtë-mujor për një Atlet të tërhequr për t'u kthyer në Garë sipas Nenit 5.7.1; një vendim i WADA-s që përcakton menaxhimin e rezultateve sipas Nenit 7.1; një vendim i një Organizate Antidoping për të mos paraqitur një Konstatim Analitik Anormal ose një Konstatim Jotipik si një shkelje të rregullit Antidoping sipas një hetimi sipas Nenit 7.7; një vendim për të vendosur një Pezullim Provizor si rezultat i një Gjykimi Provizor; një mosrespektim nga një Organizatë Antidoping të Nenit 7.9; një vendim që një Organizatë Antidoping nuk e ka juridiksionin për të vendosur mbi një shkelje të rregullit Antidoping ose Pasojat e saj; një vendim për të pezulluar, ose mospezulluar një periudhë Papërshtatshmërie ose për të rivendosur ose mos rivendosur një periudhë të pezulluar Papërshtatshmërie sipas Nenit 10.6.1; një vendim sipas Nenit 10.12.3; dhe një vendim nga një Organizatë Antidoping për të mos njohur një vendim të një Organizate tjetër Antidoping sipas Nenit 15 mund të ankimohet ekskluzivisht sipas parashikimit në Nenin 13.2 – 13.7.

13.2.1 Ankimet në lidhje me Atletët e Nivelit Ndërkombëtar ose Aktivitetet Ndërkombëtare

Në rastet që rrjedhin nga pjesëmarrja në një Aktivitet Ndërkombëtar ose në rastet që kanë të bëjnë me Atletë të Nivelit Ndërkombëtar, vendimi mund të ankimohet ekskluzivisht tek CAS-i.

NENI 14 KONFIDENCIALITETI DHE RAPORTIMI

14.1 Informacioni në lidhje me Konstatimet Analitike Anormale, konstatimet Atipike dhe Shkelje të tjera të Pretenduara të Rregullit Antidoping

14.1.1 Njoftimi i Shkeljeve të Rregullit Antidoping drejtuar Atletëve ose Personave të tjerë

Njoftimi drejtuar Atletëve ose Personave të tjerë që ndaj tyre pretendohet një shkelje e rregullit Antidopingsipas parashikimit në Nenin 7 dhe 14 të këtyre Rregullave anti-Doping. Njoftimi drejtuar Atletit ose Personit tjetër që është anëtar i Federates së Karates së Kosovës.

14.1.2 Njoftimi i Shkeljeve të Rregullit Antidoping drejtuar Federatave Ndërkombëtare dhe WADA-s. Njoftimi i pretendimit të një shkeljeje të rregullit Antidoping drejtuar Federatave Ndërkombëtare dhe WADA-s kryhet sipas parashikimit sipas neneve 7 dhe 14 të këtyre Rregullave Anti-Doping, njëkohësisht me njoftimin drejtuar **Atletit ose Personit tjetër**.

14.1.3 Përbajtja e një Njoftimi për Shkeljen e Rregullit Antidoping Njoftimi i një shkeljeje të rregullit Antidoping sipas Nenit 2.1 përfshin: emrin e Atletit, vendin, sportin dhe disiplinën brenda sportit, nivelin konkurrues të Atletit, nëse analizat kanë qenë Brenda-Gare apo jashtë-Gare, datën e marrjes së Ekzemplarit, rezultatin analitik të raportuar nga laboratorit dhe informacionin tjetër që kërkohet nga Standardi Ndërkombëtar për Analiza dhe Hetime. Njoftimi i shkeljeve të rregullit Antidopingtë ndryshme nga ato sipas Nenit 2.1 përfshijnë rregullin e shkelur dhe bazën për shkeljen e pretenduar.

14.2 Fshehtësia e të Dhënave

14.2.1 Kur kryen detyrimet sipas këtyre rregullave, Federata e Karates së Kosovës mund të mbledhë, ruajë, procesin apo të zbulojë informacion personal, lidhur me Atletët dhe Personat e tjerë, kur është e nevojshme dhe e përshtatshme për të kryer aktivitetet e tyre Antidoping në bazë të Kodit, Standardet Ndërkombëtare (duke përfshirë specifikisht Standardin Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Jetës Private dhe Informacionit Personal) dhe këtyre Rregullave anti-Doping.

14.2.2 Çdo Pjesëmarrës i cili dorëzon informacion, përfshirë të dhëna personale të ndonjë personi, në pajtim me këto Rregulla anti-doping, do të konsiderohet se kanë rënë dakord, në pajtim me ligjet e aplikueshme për mbrojtjen e të dhënave dhe të tjera, që një informacion i tillë mund të mbledhen, përpunohen, zbulohet dhe të përdoret nga ky Person për qëllime të zbatimit të këtyre Rregullave Anti-Doping, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për mbrojtjen e Jetës private dhe Informacionit Personal dhe të tjera , siç kërkohet për zbatimin e këtyre Rregullave Anti-Doping.

NENI 15 ZBATIMI DHE NJOHJA E VENDIMEVE

15.1 Në pajtim me të drejtën e ankimit të parashikuar në Nenin 13, (Ankimet) Analizat, rezultatet e gjykimit apo gjykime të tjera të një Nënshkruesi që janë në pajtim me Kodin dhe janë brenda autoritetit të atij Nënshkruesi njihen dhe respektohen nga FKK-ja dhe klubet antare te saj.

(Koment për nenin 15.1: Masa e njohjes së vendimeve TUE të Organizatave të tjera Antidoping përcaktohet nga Neni 4.4 dhe Standardi Ndërkombëtar për Përgjashtimet për Përdorim Terapik.)

15.2 FKK dhe klubet antare te saj njohin masat e marra nga organet e tjerë që nuk kanë pranuar Kodin, nëse rregullat e atyre organeve janë në pajtim me Kodin.

(Koment për Nenin 15.2: Nëse vendimi i një organi që nuk ka pranuar Kodin në disa aspekte është në pajtim me Kodin dhe në aspekte të tjera jo në pajtim me Kodin, FKK ose klubet antare duhet të përpiqen të zbatojnë vendimin në mënyrë harmonike me parimet e Kodit.)

15.3 Në pajtim me të drejtën e ankimit të parashikuar në Nenin 13 (Ankimet), çdo vendim i FKK-së në lidhje me shkeljen e këtyre Rregullave Antidoping njihen nga të gjitha Klubet Antare, që marrin të gjitha veprimet e nevojshme për t'i dhënë fuqi këtij vendimi.

NENI 16 BASHKPUNIMI I RREGULAVE ANTI-DOPING ME KLUBET ANTARE TE FKK-s

16.1 Të gjitha Klubet Antare të FKK-s duhet të përputhen me Rregullat Anti-Doping. Këto Rregulla Antidoping duhet gjithashtu të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me referencë në rregullat e çdo Klubi Antar kështu që FKK mund t'i zbatojë ato vetë drejtpërdrejt kundrejt Atletëve dhe Personave të tjerë nën juridiksionin.

16.2 Të gjitha Klubet Antare të FKK-s duhet të raportojnë çdo informacion që ka të bëjë në lidhje me një shkelje të rregullit Anti-Doping të FKK-s dhe dhe Federatës Ndërkombëtare.

16.3 Të gjitha Klubet Antare të FKK-s të kenë rregulla disiplinore për të parandaluar përdorimin e Substancave të Ndaluara.

16.4 Të gjitha Klubeve Antare do të ju kërkohet të kycejnë edukimin Antidoping në kordinim me Federatën e Karates se Kosoves.

NENI 17 PARASHKRIMI

Asnjë veprim nuk mund të fillohet në ngarkim të një Atleti ose Personi tjetër përveç kur ai është njoftuar për shkeljen e rregullit Antidoping sipas parashikimit në Nenin 7, ose njoftimi është përpjekur të bëhet në mënyrë të arsyeshme, brenda dhjetë (10) viteve nga data kur shkelja është dyshuar të ketë ndodhur.

NENI 18 ARSIMIM

FKK do të planifikojë, zbatojë, vlerësojë dhe monitorojë informacionet programet parandaluese për sportin pa doping, të paktën për çështjet e renditura në Nenin 18.2 të Kodit, dhe të mbështesë pjesëmarrjen aktive të Atletëve në programe të tilla.

NENI 19 NDRYSHIMI, INTERPRETIMI DHE VLEFESHMËRIA

19.1 Këta Rregulla Antidoping mund të ndryshohen herë pas here nga FKK-ja.

19.2 Këta Rregulla Antidoping interpretohen si një tekst i pavarur dhe autonom dhe duke mos iu referuar ligjeve ose rregulloreve ekzistuese.

19.3 Titujt e përdorur në këta Rregulla Antidoping janë vetëm për lehtësi dhe nuk konsiderohen pjesë e përmbajtjes së këtyre Rregullave Antidoping dhe nuk ndikojnë në ndonjë mënyrë gjuhën e dispozitave që u referohen.

19.4 Kodi dhe Standardet Ndërkombëtare do të konsiderohen pjesë përbërëse e këtyre Rregullave Antidoping dhe do të mbizotërojnë në rast konflikti

19.5 Këto Rregulla Antidoping janë miratuar në përputhje me dispozitat e aplikueshme të Kodit dhe do të interpretohen në një mënyrë që është në përputhje me dispozitat e zbatueshme të Kodit. Hyrja do të konsiderohet pjesë integrale e këtyre Rregullave anti-doping.

19.6 Komentet mbi dispozitat e ndryshme të Kodit dhe këto Rregulla Antidoping duhet të përdoren për të interpretuar këto Rregulla anti-Doping.

19.7 Këto Rregulla Antidoping kanë hyrë në fuqi më 1 Janar 2015, (data efektive). Ato nuk kanë fuqi prapavepruese për çështjet që janë para Datës efektive të Hyrjes në Fuqi; sidoqoftë, me kusht që:

19.7.1 Shkeljet e rregullit Antidoping që ndodhin para datës së hyrjes në fuqi, e llogaritur si "shkelja e parë" ose "shkelja e dytë" për qëllimet e përcaktimit të sanksioneve, sipas nenit 10 për shkeljet që po ndodhin pas Datës së hyrjes në fuqi.

19.7.2 Periudhat retrospektive në të cilën shkeljet e mëparshme mund të merren parasysh për qëllime të shkeljeve të shumta nga Neni 10.7.5 dhe të parashkrimit të parashikuara në nenin 17, janë rregulla procedurale dhe duhet të zbatohen në mënyrë retroaktive; sidoqoftë, me kusht që Neni 17 do të zbatohet vetëm në mënyrë retroaktive në qoftë se statuti i periudhës së parashkrimit nuk ka skaduar tashmë nga Data e hyrjes në fuqi. Në lidhje me çdo çështje të shkeljes së rregullit Antidoping që është e papërfunduar në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe çdo çështje e shkeljes së rregullit Antidoping që sillet pas Datës së Hyrjes në Fuqi bazuar në një shkelje të rregullit Antidoping që ka ndodhur para Datës së Hyrjes në Fuqi, çështja rregullohet nga rregullat lëndorë Antidoping në fuqi në momentin kur ka ndodhur shkelja e dyshuar e rregullit anti-doping, përveç kur trupi gjykoës i çështjes përcakton parimin e "lex mitior" (ligjit më të butë) zbatohet rregullisht në rrethanat e çështjes.

19.7.3 Çdo shkelje e Nenit 2.4 (qoftë mos-depozitim apo analizë e pabërë, dhe këta terma përcaktohen në Standardet Ndërkombëtare për Testim dhe Hetime) para Datës së Hyrjes në Fuqi, mbartet dhe mund të merret për bazë, para skadimit, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Testimet dhe Hetime, por do të konsiderohet se ka skaduar 12 muaj pasi ajo ka ndodhur.

19.7.4 Në lidhje me të gjitha çështjet ku vendimi përfundimtar që konstaton një shkelje të rregullit Antidoping është dhënë para Datës së Hyrjes në Fuqi, 66 por Atleti ose Personi tjetër

po vuan periudhën e Pezullimit në Datën e Hyrjes në Fuqi, Atleti ose Personi tjetër mund të bëjë kërkesë tek Organizata Antidopingqë ka patur përgjegjësinë e menaxhimit të rezultateve për shkeljen e rregullit Antidoping të shqyrtojë shkurtimin e periudhës së Pezullimit nën dritën e këtyre rregullave anti-doping. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet para skadimit të periudhës së Pezullimit. Vendimi i dhënë mund të ankimohet në pajtim me Nenin 13.2. Këto rregulla Antidoping nuk zbatohen për asnjë rast të shkeljes së rregullit Antidoping nëse është dhënë një vendim përfundimtar që konstaton një shkelje të rregullit Antidoping dhe periudha e Pezullimit ka skaduar.

19.7.5 Për qëllime të vlerësimit të periudhës së Pezullimit për një shkelje të dytë sipas Nenit 10.7.1, ku sanksioni për shkeljen e parë është përcaktuar në bazë të rregullave në fuqi para Datës së hyrjes në fuqi, zbatohet periudha e Pezullimit e cila do të ishte vlerësuar për shkeljen e parë nëse këto Rregulla Antidoping do të ishin të zbatueshme.

NENI 20 INTERPRETIMI I KODIT

20.1 Teksti zyrtar i Kodit mbahet nga WADA dhe publikohet në anglisht dhe frëngjisht. Në rastin e mospërputhjes ndërmjet versionit anglisht dhe frëngjisht, mbizotëron teksti anglisht.

20.2 Komentet në lidhje me dispozitat e ndryshme të Kodit përdoren për interpretimin e Kodit.

20.3 Kodi interpretohet si një tekst i pavarur dhe autonom dhe pa referencë në ligjet ose statutet e Nënshkruesve ose qeverive.

20.4 Titujt e përdorur për Pjesë dhe Nene të ndryshme të Kodit janë vetëm për lehtësi dhe nuk konsiderohen si pjesë e përmbajtjes së Kodit apo të ndikojnë në ndonjë mënyrë në gjuhën e dispozitave që ata u referohen.

20.5 Kodi nuk zbatohet me efekt prapaveprues për çështjet e papërfunduara para datës së pranimit të Kodit nga një Nënshkrues dhe zbatimit të tij në rregullat e tij. Megjithatë, shkeljet e rregullit Antidopingtë para-Kodit do të vazhdonin të konsideroheshin si "Shkelje të para" ose "Shkelje të dyta" për qëllimet e vendosjes së sanksioneve sipas Nenit 10 të shkeljeve pasuese pas Kodit.

20.6 Qëllimi, Objekti dhe Organizimi i Programit Botëror Antidoping dhe Kodi dhe Shtojca 1, Përkufizime, dhe Shtojca 2, Shembuj të Zbatimit të Nenit 10, konsiderohen pjesë përbërëse të Kodit.

NENI 21 ROLE DHE PËRGJEGJËSI SHITESË TË ATLETËVE DHE PERSONAVE TË TJERËS

20.1 Rolet dhe Përgjegjësitë e Atletëve,

20.1.1 njohuria dhe respektimi i këtyre rregullave Antidoping

20.1.2 I gatshëm gjithmonë për dhënjen e Mostrave

[Koment për Nenin 22.1.2: Duke pasur parasysh të drejtat e njeriut dhe privatësinë një atleti, kërkesa legjitime Antidoping nganjëherë kërkojnë mbledhjen e Mostrave natën vonë ose herët në mëngjes. Për shembull, është e njohur se disa Atletët përdorin doza të ulëta të EPO-s gjatë këtyre orëve, kështu do të jetë e padiktueshme në mëngjes.]

20.1.3 Marrja e përgjegjësisë, në kontekstin e anti-dopingut, për atë që ata konsumojnë dhe përdorin.

20.1.4 Informimi i personelit mjekësor për detyrimin e tyre për të mos Përdorur Substanca të Ndaluar dhe Metoda të Ndaluar dhe marrja e përgjegjësisë për të siguruar që çdo trajtim mjekësor i marrë nuk shkel këta rregulla anti-doping.

20.2 Rolet dhe Përgjegjësitë e Personelit Mbështetës të Atletit

20.2.1 njohuria dhe respektimi i këtyre rregullave anti-doping

20.2.2 Bashkëpunimi me programin e Analizave të Atletëve.

20.2.3 Përdorimi i ndikimit të tyre mbi vlerat dhe sjelljen e Atletëve për të forcuar qëndrimet anti-doping.

20.2.4 Nëse një mjek, gjatë ekzaminimit të një Atleti për qëllimin e lëshimit të një certificate mjekësore për të përcaktuar aftësinë mjekësore të Atletit për të marrë pjesë në garë ka shkak për të dyshuar që një Atlet ka përdorur Substanca të Ndaluar ose Metoda të ndaluar, ai është i detyruar të informojë FFK-n në lidhje me këtë.

20.2.5 Bashkëpunimi me Organizatat Antidoping që hetojnë shkeljet e rregullit anti-doping.

20.2.6 Personeli Mbështetës i Atletit nuk Përdor ose Zotëron asnjë Substancë të Ndaluar ose Metodë të Ndaluar pa justifikim të vlefshëm.

20.2.7 Një mjek i cili lëshon recetë për një Substancë të Ndaluar ose Metodë të Ndaluar për një Atlet për qëllimin e trajtimit është i detyruar të informojë Atletin nëse atij/asaj i këshillohet të vazhdojë aktivitetet sportive.

20.2.8 Përdorimi ose posedimi i një Substance të Ndaluar ose Metode të Ndaluar nga një personel mbështetës i atletëve pa justifikim të vlefshëm mund rezultojnë në një akuzë për sjellje të keqe nën disiplinën dhe ligjin e rregullav të FKK-s.

SHTOJCA 1 – PËRKUFIZIME

ADAMS: Sistemi i Administrimit dhe Menaxhimit Antidoping është një instrument menaxhimi i bazës së të dhënave bazuar në Web për hedhjen, ruajtjen, shkëmbimin dhe

raportimin e të dhënave destinuar për të asistuar aktorët dhe WADA-n në operacionet e tyre Antidoping së bashkërendim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

Administrim: Dhënia, furnizimi, mbikëqyrja, lehtësimi ose ndryshe marrja pjesë në Përdorimin ose Tentativën e Përdorimit nga një Person tjetër i një Substance të Ndaluar ose Metode të Ndaluar. Megjithatë, ky përkufizim nuk përfshin masat e personelit mjekësor në mirëbesim që përfshin një Substancë të Ndaluar ose Metodë të Ndaluar që përdoret për qëllime të vërteta dhe të ligjshme terapeutike ose justifikim tjetër dhe nuk përfshin masat që kanë të bëjnë me Substancat e Ndaluar të cilat nuk janë të ndaluara në Analizat Jashtë Gare përveç kur rrethanat në tërësi demonstrojnë që këto Substanca të Ndaluar nuk janë të destinuara për qëllime të vërteta dhe të ligjshme terapeutike ose synohen të rrisin rezultatet në sport.

Konstatim Analitik Anormal: Një raport nga një laborator i akredituar nga WADA ose laborator tjetër i aprovuar nga WADA që, në pajtim Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët dhe Dokumentet Teknike përkatëse, identifikon në një Mostër praninë e një Substance të Ndaluar ose Metaboliteve apo Shënjesve të saj (duke përfshirë sasi të larta të substancave endogjene) ose prova për Përdorimin të një Metode të Ndaluar.

Konstatim Anormal i Pasaportës: Një raport i identifikuar si një Konstatim Anormal i Pasaportës që përshkruhet në Standardet e zbatueshme Ndërkombëtare.

Organizatë Anti-Doping: Një Nënshkrues që është përgjegjës për miratimin e rregullave për fillimin, zbatimin ose ekzekutimin e një pjese të procesit të Kontrollit të Dopingut. Kjo përfshin, për shembull, Komitetin Olimpik Ndërkombëtar, Komitetin Paralimpik Ndërkombëtar, Organizatat e tjera të Aktiviteteve Madhore që kryejnë Analiza në Aktivitetet e tyre, WADA-n, Federatat Ndërkombëtare, dhe Organizatat Kombëtare Anti-Doping.

Atlet: Çdo Person që merr pjesë në sport në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar.

Pasaporta Biologjike e Atletit: Programi dhe metodat e mbledhjes dhe bashkimit të të dhënave të përshkruara në Standardin Ndërkombëtar për Analizat dhe Hetimet dhe Standardin Ndërkombëtar për Laboratorët.

Personel Mbështetës i Atletit: Çdo trajner, menaxher, agjent, personel ekipi, punonjës, personel mjekësor ose para-mjekësor, prind ose Person tjetër që punon, trajton ose asiston një Atlet që merr pjesë ose përgatitet për Garën sportive.

Konstatim Jo-Tipik: Një raport nga një laborator i akredituar nga WADA ose tjetër laborator i aprovuar nga WADA që kërkon hetim të mëtejshëm sipas parashikimit nga Standardi Ndërkombëtar për Laboratorët ose Dokumentet përkatëse Teknike para përcaktimit të një Konstatimi Anormal të Analizave.

Konstatim Jo-tipik i Pasaportës: Një raport i përshkruar në një Konstatim Jo-tipik i Pasaportës që përshkruhet në Standardet Ndërkombëtare të zbatueshme.

CAS: Gjykata e Arbitrazhit për Sportin.

Kodi: Kodi Botëror Anti-Doping.

Kontroll Doping: Të gjitha hapat dhe proceset nga planifikimi i shpërndarjes së analizave deri në disponiminia përfundimtar të një ankimi duke përfshirë të gjitha hapat dhe proceset e ndërmjetme, si dhënia e informacioni i vendndodhjes, marrja dhe trajtimi i Mostrave, analizat laboratorike, TUE-të, menaxhimi i rezultateve dhe gjykimet.

Faj: Faji është një shkelje e detyrës ose mungesë kujdesi për një situatë të caktuar.

Program i Vëzhguesit të Pavarur: Një ekip vëzhguesish, nën mbikëqyrjen e WADAs, që vëzhgon dhe mund të japë udhëzime për procesin e Kontrollit të Dopingut në Aktivitete të caktuara dhe raporton mbi vëzhgimet e tij.

Metabolite: Një substancë e prodhuar nga një proces bio-transformues.

Lista e Ndaluar: Lista që identifikon Substancat e Ndaluar dhe Metodat e Ndaluar.

Metoda e Ndaluar: Çdo metodë që përshkruhet e tillë në Listën e Ndaluar.

Substancë e ndaluar: Çdo substancë ose klasë substancash që përshkruhet si e tillë në Listën e Ndaluar.

Motratë: Çdo material biologjik që merret për qëllimet e Kontrollit Doping.

Nënshkruarit: Ato subjekte që nënshkruajnë Kodin dhe bien dakord të respektojnë Kodin, sipas parashikimit në Nenin 23 të Kodit.

Manipulimi: Ndryshimi për një qëllim të papërshtatshëm ose në një mënyrë të papërshtatshme; duke ushtruar ndikim të papërshtatshëm; duke ndërhyrë në mënyrë të papërshtatshme; duke penguar, mashtruar ose përfshirë në sjellje mashtruese për të ndryshuar rezultatin ose parandaluar kryerjen e procedurave normale.

Analiza: Pjesët e procesit të Kontrollit Doping që ka të bëjë me planifikimin e shpërndarjes së analizave, marrjen e Mostrave, trajtimin e Mostrave dhe transportin e Mostrave në laborator.

Trafikim: Shitja, dhënia, transportimi, dërgimi, furnizimi ose shpërndarja (ose Zotërimi për një qëllim të tillë) e një Substance të Ndaluar ose Metode të Ndaluar (fizikisht ose nëpërmjet mjeteve elektronike apo të tjera) nga një Atlet, Personel Mbështetës i Atletit, ose një Person tjetër që i nënshtrohet juridiksionit të një Organizate Antidoping një pale të tretë; megjithatë me kusht që ky përkufizim nuk përfshin veprimet e personelit mjekësor në "mirëbesim" që kanë të bëjnë me një Substancë të Ndaluar të përdorur për qëllime terapike legjitime dhe ligjore ose justifikim tjetër i pranueshëm, dhe nuk përfshin veprimet në lidhje me Substancat e Ndaluar që nuk janë të ndaluara në Analizat Jashtë-Gare, përveç kur rrethanat në tërësi demonstronjë që këto Substanca të Ndaluar nuk synohen për qëllime terapike legjitime dhe ligjore ose synohen për të rritur rezultatin në sport.

TUE: Përrjashtim për përdorim Terapeutik

Përdorimi: Përdorimi, aplikimi, konsumi ose injektimi me çfarë do lloj mjeti e një Substance të Ndaluar ose Metode të Ndaluar.

WADA: Agjencia Botërore Anti-Doping

FKK: Federata e Karatesë e Kosovës

NENI 22

Kojo Rregullore hyn në fuqi nga data e miratimit nga bordi i FKK-së, ndersa fillon të zbatohet nga dita kur do t'iu dergohët anëtarëve të Federatës.

Prishtinë

20 Qershor 2021

Ismet Krasniqi

Kryetar i FKK-së

